



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK**

**N J O F T I M**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të institucioni i Komisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

**DREJTOR NË DREJTORINË E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN (paga II-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" për drejtësi.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në nivel drejtues e menaxherial.

**SPECIALIST SEKRETARIE (paga IV-a) 2 pozicione**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Diplomë të nivelit Bachelor në Drejtësi ose Gjuhë-Letërsi.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Dy vite përvojë në profesion.

**PËRKTHYES (paga II-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

**KOORDINATOR PËR MEDIAN DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË (paga III-a)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Diplomë të nivelit "Master" në Drejtësi/Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e gazetarisë, marrëdhënieve me publikun, marrëdhëniet ndërkombëtare etj.

## **SPECIALIST PRITJE ME POPULLIN (paga IV-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a)Diplomë të nivelit “Master” në Drejtësi ose Shkenca Sociale.
- b)Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c)Të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e marrëdhënieve me publikun, administratë publike, etj.

## **SEKRETAR PRANË KOMISIONERIT PUBLIK (kategoria e pagës sipas VKM nr.187/2017) 1 pozicion.**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Bachelor”.
  - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
  - Të ketë njohuri shumë të mira të programeve kompjuterike Microsoft Office.
- Eksperienca në punë përbën avantazh.

## **KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t’u pajisur me çertifikatë sigurie, sipas vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 21 deri 25 Maj 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë nga e hëna në të premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës sëbashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 25.05.2018 dhe të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti)
- Dokumentat (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetdeklarim, certifikata, trajnime etj) fotokopje ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë

jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (Vërtetim nga Gjykata, Vërtetim nga Prokuroria, Dëshmi e gjendjes gjyqësore)
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Një rekomandim nga punëdhënësi;
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumenta të fotokopjuara, përpara intervistës i parashetrojnë Komitetit ad-hoc dokumentat e njësuara ose ato origjinale.